



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 39.

Prishtinë, më 24.03.2016 në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviq, Danush Ademi dhe Veton Berisha

Munguan:, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, Slavko Simiq dhe Qerim Bajrami.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : përfaqësuese e OSBE-së - Sanije Berisha, konsulltant i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz -Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-033 si dhe ligjin nr. 04/L-115, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-033 si dhe ligjin nr. 04/L-115, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-033 si dhe ligjin nr. 04/L-115 dhe njëherit kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Pas diskutimeve në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funkcional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-033 si dhe ligjin nr. 04/L-115 dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka pas diskutime. Kryesuesja i njoftoi të pranishmit se komisioni në çdo kohë është i gatshëm të shqyrtojë projektligjet të cilat janë në procedurë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković